

Një Vështrim Mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik Të Shqipërisë

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Korrik 2021

Kjo është një përmbledhje e indikatorëve kryesorë të situatës ekonomike në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare ose organizata ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.




Përmbajtja

- Llogaritë Kombëtare
- Tregtia e Jashtme
- Tregu i Punës
- Investimet
- Tregues Monetar
- Renditja e Shqipërisë sipas:
 - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
 - Indeksi i Lirisë ekonomike
 - Lehtësia e të Bërit biznes
 - Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore
 - Indeksi Global i Inovacionit


Ecuria e Treguesve Kryesore Makroekonomikë

- ❖ *Përgjatë T1 2021, ekonomia vazhdoi trajektoren rritëse të nisur nga TIV 2020 duke shënuar rritje vjetore 5,5%*
- ❖ *Inflacioni mbeti nën objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3% dhe regjistroi 1,3% gjatë 6MI të vitit 2021, 0,5 p.p më pak se 6MI 2020*
- ❖ *Flukset e IHD-ve gjatë T1 2021 ranë me 1,3% krahasuar me T1 2020, ndërsa stoku i IHD-ve u rrit me 14,7%. Hollanda vazhdon të jetë lider në flukset hyrëse të IHD-ve megjithëse me një ritëm në rënie. Për T1 2021, Industria nxjerrëse ka qënë aktiviteti më tërheqës për IHD-të.*
- ❖ *Gjatë T1 2021, norma zyrtare e papunësisë regjistroi shifrën 11,9% me rritje 0,5 p.p krahasuar me një vit më parë.*

Ecuria e Rritjes Ekonomike



Rimëkëmbja ekonomike e Shqipërisë e nisur nga viti 2015, u ngadalësua përgjatë vitit 2019 dhe ra përgjatë vitit 2020 me -3,3%, si rezultat i pandemisë COVID19




Përballimi i dy emergjencave civile të njëpasnjëshme, Tërmeti i Nëntor 2019 dhe pandemia COVID-19, kanë ulur ndjeshëm parashikimet e rritjes ekonomike të Shqipërisë, dhe jo vetëm, për **vitin 2020**.



Ecuria e Rritjes Ekonomike


Rritja ekonomike e Shqipërisë



Bazuar në të dhënat paraprake, Produkti i Brendshëm Bruto gjatë vitit 2020 në Shqipëri ra me 3,3%, më pak se parashikimet e mëparshme.

PBB arriti në 1607,9 miliardë lekë nga 1679,2 në vitin 2019.

Rritja Ekonomike sipas Tremujorëve




Pas uljes 3,3% të vlerësuar në vitin 2020, bazuar në të dhënat e INSTAT, ekonomia shqiptare ka filluar rimëkëmbjen.

Edhe gjatë tremujorit I 2021 PPB e vendit u rrit me 5,5% duke vijuar rritjen e filluar që nga tremujori IV 2020.


Kontributin më të madh në rritjen ekonomike të TI 2021 e kanë dhënë degët Energjia dhe Uji (2,56 p.p) dhe Ndërtimi (1,09 p.p). Negativisht kontribuan aktivitetet: Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative me -0,20 p.p. dhe Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor me - 0,14 p.p.

Rritja sipas Sektorëve dhe Shpenzimeve Kryesore

Rritja vjetore (%)




Rritja vjetore (%)



Kontributi në PBB sipas Aktiviteteve kryesore

Kontributi në rritje (pikë përqindje)





Industria, Ndërtimi dhe Administrata publike kanë dhënë kontributin kryesor në rritjen ekonomiketë TI 2021




E Ardhura për Frymë

Për vitin 2020, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet **5.215 USD** në vlerë korrente, në të njëjtat nivele të një viti më parë


E ardhura për frymë (USD për frymë)



Produkti i Brendshëm Bruto për frymë (USD/frymë): 2020



Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme




Gjatë vitit 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën **272 mld lekë**, duke u ulur me **9 %**, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën **605 mld lekë**, duke u ulur me **7 %**, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën **146 mld lekë**, duke u ulur me **12 %**, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

Eksportet e Mallrave

Eksporte sipas produkteve




Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre edhe gjatë vitit 2020, ku pjesa më e madhe janë **Tekstile** dhe **Këpucë** të ndjekur nga Minerale lëndë djegëse, energji elektrike dhe Ushqime pije dhe duhan.




Importet e Mallrave

Struktura e importeve të mallrave vazhdon të dominohet nga importet e **Makineri, pajisje, Ushqimeve, pije, duhan** dhe Makineri, dhe Produkte kimike dhe plastike.





Qarkullimi i Mallrave -Tregtia e Jashtme sipas Tremujorëve



Gjatë 6MI 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën **177 mld lekë**, **duke janë** rritur me 42 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën **354 mld lekë**, duke u rritur me 30,6 %, krahasuar me një vit më parë.

Deficiti tregtar arriti vlerën **177 mld lekë**, duke u rritur me 21%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.


Eksportet në Shërbime Konteksti Rajonal



Edhe gjatë vitit 2020, Shqipëria vazhdon të renditet e dyta në rajon përsa u përket eksportit të shërbimeve, ku dominojnë Udhëtimet me **44,3%** të totalit të eksporteve. Serbia është e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor përsa i përket eksportit të shërbimeve

Indeksi i Çmimit Të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Përgjatë 6MI 2021, inflacioni mesatar me bazë vjetore regjistroi vlerën **1.3%**, më i ulët se një vit më parë , ku Inflacioni regjistroi vlerën **1.8%**.

Bazuar edhe në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej **3%**.



Kursi i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit




Përgjatë vitit 2020, kursi mesatar i këmbimit lekë/Euro ishte 123,8 ndërsa lekë/USD ishte 108,5;

Ndërkohë përgjatë 6MI 2021, si monedha europiane EURO ashtu edhe dollari amerikan janë zhvlerësuar kundrejt lekut shqiptar.

Forca e Punës


Norma e papunësisë



Gjatë Tremujorit I 2021, Shkalla e papunësisë u rrit me **0,5 p.p** krahasuar me një vit më parë.

Referuar të dhënave të INSTAT në T1 / 2021, numri i të punësuarve u ul me 25,345 persona krahasuar me një vit më parë. Vihet re një rritje e punësimit në sektorin publik me 9.702 persona krahasuar me 2020/TI; ndërsa punësimi në sektorin privat (me përjashtim të bujqësisë ku ka një rënie prej 35.340 personash) u rrit me vetëm 290 persona.

Paga Mesatare sipas Sektorëve (Në Lekë)



Pagat më të larta janë regjistruar në sektorin e “Aktiviteteve financiare dhe sigurimit”, pasuar nga “Informacioni dhe Komunikimi”.

Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin “Bujqësi, Silvikulturë dhe Peshkim”.


Rënia më e madhe në paga është vërejtur në Bujqësi dhe Aktiviteteve financiare; ndërsa rritja më e madhe në Administratën publike sektorin e pasurive të paluajtshme.

Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer.

Paga Mesatare dhe Paga minimale

Paga mesatare mujore për një të punësuar dhe paga minimale e miratuar

- Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin shtetëror
- Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin privat
- Paga minimale e miratuar




Paga mesatare gjatë 2020 është raportuar në **56.475 lekë** me rritje **2,1%** kundrejt një viti më parë.

Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte **48.620 lekë** me një rritje **2,3%** krahasuar me një vit më parë ; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte **64.330 lekë** , me një rritje **2%** krahasuar me një vit më parë .

Paga minimale ngelet e pandryshuar në **26.000 lekë**.



Kosto e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor

Pagat mesatare për një të punësuar në Ballkanin Perëndimor (EURO)





Paga mesatare bruto më e lartë në rajon është regjistruar në Malin e Zi, e ndjekur nga Bosnjë dhe Hercegovina, **ndërkohë Shqipëria vazhdon të ketë pagën mesatare më të ulët në rajon.**

Investimet në Shqipëri





Pjesa më e madhe e investimeve në ekonomi vjen nga sektori i brendshëm. Gjatë vitit 2020, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks arriti në **23.25%** e Produktit të Brendshëm Bruto, ndërsa ato publike ishin në nivelin e **5.4%** të PBB.

Investimet sipas Sektorëve



Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, gjatë 2019, investimet private u rritën me **1,5%**, dhe **62,1%** e Investimeve vinë nga prodhuesit e të mirave. Shumica e Investimeve gjatë vitit 2019, kanë qenë investime në Makineri dhe Pajisje, **27%** e totalit, duke ruajtur të njëjtin trend të vitit të mëparshëm edhe pse më një rënie prej **6p.p.**

Investimet e Huaja Direkte




Gjatë TI 2021, fluksi hyrës i IHD ka rënë me **1,3%** krahasuar me një vit më parë. Edhe pse flukset hyrëse të IHD kanë qënë mjaft të ndryshueshme sipas cikleve të biznesit, që nga 2015 stoku i IHD në Shqipëri ka ruajtur një trend rritës deri ne TIV 2019 dhe ka filluar sërish rimëkëmbjen gjatë TII 2020.

Gjatë TI 2021, stoku I IHD u rrit me **14,7%** krahasuar me një vit më parë




Investimet e Huaja Direkte

Fluksi IHD sipas vendit të origjinës, milion EURO




Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, milion EURO



Gjatë TI 2021, Holanda udhëheq fluksin e IHD edhe pse me rënie krahasuar me një vit më parë; Industria nxjerrëse është aktiviteti më tërheqës për TI 2021 edhe pse më rënie krahasuar me TI 2020.

Investimet e Huaja Direkte


Fluksi IHD sipas aktivitetit ekonomik, milion EURO



Sektorët më tërheqës për IHD-të ngelen **Energjia elektrike, Minierat dhe Industritë Nxjerrëse**, dhe, edhe pse kjo e fundit në rënje duke filluar nga viti 2019.

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor, % PBB




Shqipëria renditet e dyta në rajon për IHD me **7,9%** të PBB

Serbia udhëheq rajonin përsa i përket flukseve hyrëse të IHD të cilat janë sa **8,3%** e PBB

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor

Fluksi i IHD Në Ballkanin Perëndimor, milion USD



Flukset hyrëse të IHD në Serbi arritën në **4 miliardë USD** për vitin 2019, ndërsa në Shqipëri ato kapën shifrën e **1,2 miliardë USD**

Vendi me më pak flukse hyrëse të IHD në rajon është Kosova me **285 milionë USD**.


Stoku dhe Profili i Ndërmarrjeve

Struktura e ndërmarrjeve
në ekonominë shqiptare
dominohet nga
ndërmarrje të vogla me 1-
4 të punësuar


Sipas numrit të të punësuarve	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Gjithsej	152,288	160,679	162,452	162,835	162,342	166,386
1-4	136,470	145,456	146,304	145,549	144,857	149,772
5-9	8,172	7,631	8,023	8,518	8,569	7,583
10-49	5,994	5,902	6,297	6,801	6,932	7,052
50+	1,652	1,690	1,828	1,967	1,984	1,979
Prodhuesit e të mirave	37,950	48,585	53,250	56,916	60,061	65,042
1-4	33,255	44,179	48,819	52,269	55,342	60,403
5-9	2,080	1,865	1,842	1,858	1,871	1,704
10-49	1,971	1,877	1,851	1,987	2,052	2,177
50+	644	664	738	802	796	758
Prodhuesit e shërbimeve	114,338	112,094	109,202	105,919	102,281	101,344
1-4	103,215	101,277	97,485	93,280	89,515	89,369
5-9	6,092	5,766	6,181	6,660	6,698	5,879
10-49	4,023	4,025	4,446	4,814	4,880	4,875
50+	1,008	1,026	1,090	1,165	1,188	1,221

Ndërmarrjet Aktive sipas Aktivitetit Ekonomik


Ndërmarrje aktive fund viti




Ndërmarrje aktive, fund viti




Ndërmarrje të reja




Ndërmarrje të reja të regjistruara



Kredia për ekonominë



Kredia e re Janar - Maj 2021 sipas sektorëve




Kredia totale për ekonominë arriti në 618 miliardë lekë në Maj 2021 ndërsa shumica e kredisë së re gjatë shkoi në tregtinë me shumicë dhe pakicë me 29% të totalit.

Renditja e Shqipërisë në Raportet dhe Indekset Ndërkombëtare

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit, Transparency International							
Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
36,0	104/180	35,0	106/180	36,0	99/180	38,0	91/180
Indeksi i Lirisë Ekonomike, heritage.org							
Vlera 2021	Renditja 2021	Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018
65,2	66/180	66,9	57/180	66,5	52/180	64,5	65/180
Të bërit biznes, Banka Botërore							
		Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018
		67,7	82/190	69,5	63/190	68,7	65/190
Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore, Forumi Ekonomik Botëror							
		Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
		57,6	81/141	58,0	76/140		75/137
Indeksi Global për Inovacionin							
Vlera 2020	Renditja 2020	Vlera 2019	Renditja 2019	Vlera 2018	Renditja 2018	Vlera 2017	Renditja 2017
27,23	83/131	42,42	70/129	29,98	83/126	28,86	115/127


Treguesi i Lehtësisë Së Të Bërit Biznes



Maqedonia e Veriut ka renditjen më të mirë në rajon edhe pse pozitën e saj janë përkeqësuar gjatë vlerësimit të 2020;


edhe Shqipëria ka përkeqësuar pozitën e saj gjatë vlerësimit 2020, krahasuar me një vit më parë.

Indikatorët e Të Bërit Biznes



Shqipëria renditet më poshtë në fushën e trajtimit të lejeve të ndërtimit, energjisë, procedurave fiskale dhe regjistrimit të pronës.

Indikatorët E Konkurrueshmërisë




Gjatë 2019, indikatorët Infrastruktura, dhe Sistemi Financiar janë përmirësuar; ndërsa indikatorët Institucionet, Sofistikimet e biznesit dhe Inovacioni janë përkeqësuar.



Liria Ekonomike

Trendi i Lirisë Ekonomike, Shqipëria




Shqipëria renditet e **57a** në rang botëror, duke humbur pesë pozicione nga viti i kaluar; Në rang rajonal, Shqipëria renditet e **30a** nga 44 vende europiane


Vendi qëndron poshtë mesatares europiane (**69.3**) por është mbi mesataren botërore (**61.6**)

Treguesit e Lirisë Ekonomike


Treguesit e Lirisë Ekonomike
Sundimi i Ligjit




Madhësia e qeverisë



Efektiviteti rregullator



Liria e të bërit tregti



Indeksi Global i Inovacionit

	2015	2016	2017	2018	2019	2020
SRB	70	65	58	56	57	53
MNE	40	46	52	55	45	49
ALB	112	71	115	83	70	83
MKD	55	62	63	84	59	57
BIH	122	104	86	68	71	74

Rreth Këshillit të Investimeve në Shqipëri

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Staf

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



European Bank
for Reconstruction and Development



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).